



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government



Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force

Departamenti i Personelit/ Odsek za personal/Department for Personnel

Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr.03/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-82 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Neni 9 i Rregullores Nr. 21/2017 për Atashetë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës shpall:

K O N K U R S I B R E N D S H Ë M

Titulli i pozitës: **Atashe i FSK-së**

Organizata : **Francë, Itali,**

Vendi: **Parisë, Romë**

Misioni i FSK-së;

Forca e Sigurisë së Kosovës, është forcë krejtësisht vullnetare e ndërtuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës, si instrument i sigurisë, është që ta mbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Territori i fushëveprimit:

Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës mund të angazhohen jashtë kufijve territorial të Republikës së Kosovës kur janë të ftuar nga organizatat ndërkombëtare anëtare e të cilave është apo aspiron të bëhet Republika e Kosovës, apo në baza bilaterale me pjesëtarët e këtyre organizatave dhe pas autorizimit ministror.

Të drejtat individuale të personelit të FSK-së:

Pjesëtarëve të FSK-së u ofrohet trajtim i drejtë dhe i barabartë pavarësisht nga gjinia ose etnia, mundësinë për të pasur karrierë të plotë dhe për të realizuar plotësisht potencialin e tyre përmes praktikës së emërimit, ngritjes në detyrë dhe zhvillimit në bazë një sistemi të përgjithshëm të meritave dhe transparencës.

Kriteret për konkurrim ;

- Të jetë pjesëtar aktiv i FSK-së me gradën Nënkolonel (OF4) e lartë,
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze në nivelin STANAG III,
- Të kaloj procesin e verifikimit që është i nevojshëm,
- Të mos ketë të shqiptuar ndonjë masë për shkelje disiplinore,
- Njohja e një gjuhe të shtetit pranues – përparësi,
- Të ketë arritur rezultat të lartë në vlerësimet vjetore të performancës.

Kohëzgjatja e emërimit;

- Mandati i Atasheut të Mbrojtjes është 4 (katër) vite, me mundësi vazhdimi edhe për një (1) vit në të njëjtin shtet, nëse ky mandat nuk ndërpritet ma herët.
- Emërimi i Atasheut të Mbrojtjes për mandatin e dytë ne shtete tjera bëhet duke kaluar ne procedurat e përzgjedhjes, ne bazë të vlerësimit dhe nevojave te MFSK dhe FSK.
- Pas përfundimit te shërbimit atasheu i mbrojtjes rikthehet ne pozicionin e mëparshëm, duke rifituar statusin dhe pozitën qe ka pasur ose në një pozicion ekuivalent me të.

Afati për konkurrim;

- Konkursi është i hapur nga data **06.11.2018** deri më **13.11.2018**.

Si të aplikoni;

Kandidatët duhet ta plotësojnë dhe nënshkruajnë formularin e aplikimit, dhe duhet ta dorëzojnë personalisht pranë zyrës së personelit të njësisë në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Formularët e aplikimit do të jenë në dispozicion në zyrat e personelit pranë njësive të FSK-së, ku gjendet shpallja e konkursit. Kandidatët mund t'i bashkëngjisin kopjet e dokumenteve/certifikatave/diplomave të cilat i kanë marrë së fundi e që nuk janë evidentuar ende në dosjen e tyre personale.

Për informata plotësuese, kandidatët mund të kontaktojnë zyrat e personelit të njësive organizative të FSK-së, apo në Departamentin e Personelit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në numrin 038-200-13-508.

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës ofron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së dhe mirëpret aplikacionet e tyre për atashe të FSK-së, pa dallim nga përkatësia etnike apo gjinore.